**Informacioni parakontraktor**

INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË KUFI MBI PAGEN
ANEKS NR. 1

**1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës**

| | |
|---|---|
| Banka<br>Adresa<br>Numri i telefonit (*)<br>Adresa e postës elektronike (*)<br>Adresa e web-it | Raiffeisen Bank Sh.a<br>"Rruga e Kavajës", Tiranë, Shqipëri<br>_+355 2 222 669; Call Center +355 4 2 274 910_<br>info@raiffeisen.al, ankesa.online@raiffeisen.al,sugjerime@raiffeisen.al<br>https://www.raiffeisen.al |
| _(*) Ky informacion është opsional për Bankën_ | |

**2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë (Kredi Kufi/Overdraft)**

| | |
|---|---|
| Teksti prezantues | Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk parasheh detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi. |
| Lloji i kredisë | Kredia Kufi/Overdraft është kredia konsumatore sipas së cilës banka i jep konsumatorit mundësinë e disponimit të fondeve në llogarinë e tij rrjedhëse/të pagës, që tejkalojnë gjendjen aktuale të fondeve në këtë llogari, deri në një kufi të paracaktuar në kontratë. |
| Vlera totale e kredisë dhe monedha<br>_(Nënkupton kufirin maksimal ose shumën totale të disponueshme, të kredisë)_ | Vlera totale e kredisë është kufiri i Kredisë Kufi (Overdraftit), sipas kontratës së kredisë.<br><br>**Shuma maksimale – deri në 3 paga neto mujore** (maksimumi 400,000 ALL / 3,000 EUR).<br>**Monedha**: LEK/EUR.<br><br>*Kredia Kufi ofrohet vetëm për klientët të cilët marrin pagën në Bankën tonë.<br>**Kredia Kufi në Euro ofrohet vetëm për klientët që marrin pagën në monedhën Euro. |
| _Nëse është e aplikueshme_<br>Kredia është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat. | Nuk është e aplikueshme.<br>*Kredia Kufi ofrohet gjithmonë në të njëjtën monedhë me monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, pra me monedhën e pagës. |
| _Nëse është e aplikueshme_<br>Vlera e këstit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë. | Nuk është e aplikueshme. |
| Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve<br>_(Nënkupton si dhe kur do merren paratë)_ | Si kusht për lëvrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një llogari rrjedhëse pranë Bankës Raiffeisen, e quajtur "llogaria e kredisë", llogari në të cilën konsumatorit duhet ti kalojë edhe paga e tij. Në këtë llogari, Banka do të bëjë disbursimin e fondeve të kredisë kufi dhe nëpërmjet saj do të bëhet ripagimi i kredisë.<br><br>Mbas disbursimit të kësaj kredie, klientit i kalojnë fondet në llogarinë rrjedhësë/të pagës, të cilat mund ti përdorë/tërheqë nëpërmjet sporteleve të Bankës, me mjete elektronike, ose me kartë debiti. |
| Kohëzgjatja e kontratës së kredisë | Kohëzgjatja e kontratës së kredisë do të jetë sipas zgjedhjes së klientit në momentin e aplikimit, duke filluar nga 3 muaj deri në moshën 60 vjeç (F) dhe 65 vjeç (M) në maturimin e kredisë.<br>**Më pas, do të vijojë derisa klienti të ndërpresë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin, ose kur verifikohet se paga e tij nuk kalon më nëpërmjet Bankës.** |
| Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet | Klienti ka të drejtë të përdorë të gjithë shumën e Kredisë Kufi, deri në kufirin e aprovuar në kontratën e kredisë.<br>Kryegjëja mund të paguhet me pjesë sipas dëshirës së klientit në çdo moment, ose në bazë të kreditimeve që kalojnë në llogarinë rrjedhëse/të pagës.<br>Interesi aplikohet vetëm mbi shumën e përdorur dhe vetëm për ditët për të cilat është përdorur kredia, dhe paguhet çdo fund muaji.<br>Për Kredinë Kufi nuk aplikohen komisione.<br><br>Llogaritja e interesit mujor do të bëhet sipas shembullit më poshtë:<br>Shembull:<br>_Shuma e miratuar e kredisë = 100,000 Lekë_<br>_Shuma e përdorur e kredisë = 50,000 Lekë_<br>_Periudha e përdorimit të kredisë = 1 ditë_<br>_Interesi i Bonove të Thesarit 12-mujore më i fundit i publikuar = 2.75% (nëse supozojmë se vlera e Bonos së Thesarit do të mbetet e pandryshueshme)_<br>_Norma e interesit të pandryshueshëm të kredisë = 10.40%_<br>_Interesi total i kredisë = 13.15% (2.75% + 10.40%)_<br>_Shuma e interesit standart = 50,000*(2.75% +10.40%)*1/365 = 18.01 Lekë_ |
| Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar<br>_(Nënkupton shumën e fondeve të mundshme për t'u marrë hua, plus interesat dhe kostot e mundshme që lidhen me kredinë)_ | Shuma totale që klienti do të paguajë për kredinë e kërkuar (kryegjë + interes) llogaritet çdo muaj sipas përdorimit të kredisë, në varësi të ndryshimeve të Interesi i Bonove te Thesari  12-mujore/Euribor (indeksit orientues) dhe kreditimeve të llogarisë rrjedhëse/të pagës.<br><br>Shlyerja e kredisë së përdorur do të kryhet nëpërmjet kreditimeve që kalojnë në llogarinë rrjedhëse/të pagës. Detyrimi minimal i klientit është pagesa e interesit mujor të gjeneruar nga përdorimi i kredisë.<br><br>Llogaritja e interesit për shumën totale që konsumatori do të ketë për të paguar do të bëhet sipas shembullit më poshtë:<br>Shembull:<br>_Shuma e miratuar e kredisë = 100,000 Lekë_<br>_Kohëzgjatja e kontratës së kredisë = 3 muaj_<br>_Shuma e përdorur e kredisë = 100,000 Lekë (e gjithë shuma e aprovuar)_<br>_Periudha e përdorimit të kredisë = 3 muaj/90 ditë, duke konsideruar që klienti nuk ka kryer asnjë pagesë detyrimi_<br>_Interesi i Bonove te Thesarit 12-mujore më i fundit i publikuar = 2.75% (nëse supozojmë se vlera e Bonos së Thesarit do të mbetet e pandryshueshme)_<br>_Norma e interesit të pandryshueshëm të kredisë = 10.40%_<br>_Interesi total i kredisë = 13.15% (2.75% + 10.40%)_<br>_Interesi standart = 100,000*13.15%*90/365 = 3,242.46 Lekë_<br>_Shuma totale që klienti do të paguajë për kredinë në fund të 3 muajve = 103,242.46 Lekë_ |
| _Nëse është e aplikueshme_<br>Garanci/siguri të nevojshme<br>_(Përshkrimi i garancisë që do të ofrohet në lidhje me kontratën e kredisë)_ | Nuk kërkohet kolateral. |

**3. Kostoja e kredisë**

| | |
|---|---|
| Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë | Për Kredinë Kufi aplikohet normë e ndryshueshme e interesit (e cila llogaritet mbi bazën e një indeksi orientues dhe një marzhi fiks).<br><br>Raiffeisen BANK sh.a., e përcakton normën e interesit të kredisë suaj bazuar tek Interesi i Bonove të Thesarit/Euribor (1-vjeçar) për Kreditë në ALL/EUR, plus një përqindje fikse për gjithë periudhën e kredisë.<br><br>_Interes i Bonove të Thesarit/Yield mesatar i ponderuar është norma e titujve te Qeverisë Shqiptare me afat 12 mujor, që rezulton nga ankandi i fundit organizuar nga Banka e Shqipërisë, si ndërmjetëse për shitjen  e letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare.  Rezultatet nga  ankandet e bonove shpallen në të njëjtën ditë të organizimit të ankandit dhe publikohen në faqet respektive të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqiperisë._<br><br>_EURIBOR është Norma e Interesit Ndërbankar për EURO-n. Kjo normë llogaritet nga Federata Bankare Europiane (FBE) dhe publikohet cdo ditë biznesi në orën 11(ora belge). Normat e Euribor ndryshojnë çdo ditë pune bankare dhe mund t'i gjeni të publikuar edhe në sportelet e RBAL._<br><br>Kredimarrësi do të njihet me normat e interesit te aplikuara për periudhën paraardhëse 12-mujore në njërën prej mënyrave të njoftimit të përcaktuar në Kontratën e kredisë: duke u paraqitur në bankë, nëpërmjet platformës digjitale Raiffeisen ON, me postë elektronike ose të thjeshtë.<br><br>Norma e interesit  për kredinë e interesuar do të ofrohet sipas përcaktimeve më poshtë:<br><br>Klientë pagamarrës në RBAL:<br>Monedha LEK: Interesi i Bonove të Thesarit 12M  + 10.40%<br>Monedha EUR: EURIBOR + 11%<br><br>* Në rastet kur Norma Bazë e interesit ka vlerë negative, Banka në kalkulimin e interesit do ta konsiderojë me vlerë 0. |
| Norma efektive e interesit (NEI)<br>_Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 dhe aneksin nr. 1 të rregullores nr. 59 "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare"._ | NEI është norma e interesit që përfshin të gjitha kostot e kredisë për të cilën klienti po aplikon.<br>Totali i kostos së kredisë për klientin është totali i të gjitha shpenzimeve ku përfshihen interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që klienti paguan për kredinë sipas kushteve të marrëveshjes së kredisë.<br>Klienti do të informohet për vlerën e përafërt të NEI në momentin e aplikimit. Vlera e saktë e NEI-t do të jepet në kontratën e kredisë.<br><br>Norma efektive e Interesit (NEI) për Kredinë Kufi me pagë, sipas kushteve të specifikuara më poshtë është: 13.15%.<br>Shembull:<br>_Shuma 500,000 LEK;_<br>_Numri i pagesave mujore 12;_<br>_Interesi i Bonove te Thesarit 12-mujore më i fundit i publikuar = 2.75% (nëse supozojmë se vlera e Bonos së Thesarit do të mbetet e pandryshueshme)_<br>_Norma e interesit të pandryshueshëm të kredisë = 10.40%_<br>_Interesi total i kredisë = 13.15% (2.75% + 10.40%)_<br>_Komisioni Administrimit 0%_<br>_NEI: 13.15%_ |

Classification: PUBLIC

| | |
|---|---|
| A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar:<br>-kontratat e sigurimit për kredinë?<br>*Nëse kostot e këtyre shërbimeve nuk njihen nga banka, ato nuk do të përfshihen në NEI.* | Nuk aplikohet asnjë kosto tjetër e lidhur me kredinë. |
| Kosto të tjera të lidhura me kredinë<br>*Nëse është e aplikueshme*<br>Mbajtja e një ose më shumë llogarive është e kërkuar për të regjistruar si transaksionete pagesave ashtu edhe tërheqjet apo transferimet e fondeve nga njëra llogari në tjetrën. | Nuk aplikohet asnjë kosto tjetër e lidhur me kredinë. |
| Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë | Nuk aplikohet asnjë kosto tjetër e lidhur me kredinë. |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese (p.sh. një kartë krediti) | Nuk aplikohen kosto të tilla. |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë | Nuk ka kosto të tjera. |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Kushtet, sipas të cilave kostot e sipër përmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë | Nëse është e aplikueshme, Banka ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar bashkë me fitimin e munguar, për shkak të vonesës në pagimin e detyrimit nga kredimarrësi, edhe në rastet kur për faj të këtij të fundit bëhet i pamundur ekzekutimi i detyrimit nga kredimarrësi. |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale. | Klienti nuk ka asnjë detyrim për shpenzime noteriale. |
| Kostot në rastin e pagesave me vonesë<br>*Mungesa e pagesave të kësteve mund të sjellin pasoja të rënda për konsumatorin dhe e bëjnë procesin e mbajtjes së kredisë më të vështirë.* | Konsumatori do të ngarkohet me [... (normën e interesit të aplikuar dhe detyrime shtesë që lidhen me rastin e mospagesës në kohë të kredisë)].<br><br>Në rast se tejkalohet limiti i Overdraftit i aprovuar nga banka, klienti do të paguajë interes penalizues në vlerën Interes i Bonove të Thesarit 12-mujore (interesi i fundit i publikuar deri në momentin e përdorimit të kredisë) + 0% në vit e llogaritur çdo ditë mbi totalin e balancës debitore që tejkalon shumën e kredisë së miratuar, gjatë kohës që është kaluar limiti sipas kushteve të kontratës. Përllogaritja e penalitetit do të fillojë ditën e parë pas ditës së tejkalimit të limitit dhe do të debitohet në llogarinë e klientit në fund të muajit. Penaliteti do të llogaritet mbi shumën e tejkaluar të limitit të kredisë dhe për sa ditë klienti e ka tejkaluar këtë limit. Penalitetet dhe kamatëvonesat, të cilat paguhen nga kredimarrësi, nuk do të tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30 për qind të shumës së detyrimit kontraktor (këstit/kësteve të papaguar të kredisë, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë + interesin).<br><br>Llogaritja e interesit penalitet në rast mospagese të shumës që tejkalon limitin e miratuar të kredisë do të bëhet sipas shembullit më poshtë:<br>Shembull:<br>*Shuma në vonesë pagese (nga interesi standart/komisionet) = 10,000 Lekë*<br>*Ditët në vonesë pagese = 10 ditë*<br>*Interesi i Bonove te Thesarit 12-mujore më i fundit i publikuar = 2.75% (nëse supozojmë se vlera e Bonos së Thesarit do të mbetet e pandryshueshme)*<br>*Norma e interesit të pandryshueshëm të penalitetit = 0%*<br>*Norma e interesit penalitet = 2.75% (2.75% + 0%)*<br>*Shuma e interesit penalitet = 10,000*2.75%*10/365 = 7.53 Lekë* |

**4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore**

| | |
|---|---|
| E drejta për t'u tërhequr | Klienti ka te drejtë të tërhiqet nga kontrata e kredisë pa ndonjë arsye, brenda 14 ditëve nga nënshkrimi i kontrates së kredisë, vetëm në rastet kur klienti, pas plotesimit të kërkesës me shkrim, paguan të plotë shumën e kredisë së përfituar plus interesat e përllogaritura për ditët përkatese. |
| Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit<br>*Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, paraafatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë.* | Klienti mund të shlyejë plotësisht ose pjesërisht para afatit shumën e kredisë në çdo moment, me kusht që të ketë paguar më parë të gjitha interesat e përllogaritura deri në momentin e shlyerjes.<br>Banka nuk aplikon asnjë penalitet për shlyerje të parakohshme. |
| Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit) | Nuk është e aplikueshme. |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Produkte/shërbime shtesë:<br><br>*(Ky informacion është opsional për bankën)*<br>Çdo produkt/shërbim shtesë i ofruar nga banka së bashku me kontratën e kredisë dhe që nuk është përmendur në seksionet e mësipërme. | Informacion mbi produktet/shërbimet shtesë të ofruara nga banka: [Vendosni llojin e produkteve të ofruara]<br>Për shembull: "llogari rrjedhëse e lidhur me kredinë"; "llogari kursimi e lidhur me kredinë; "produkte/forma investimi","kontratë sigurimi e lidhur me kredinë" etj.<br><br>Produkte/shërbime shtesë: Llogari rrjedhëse/page e lidhur me kredinë. |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit. | Nuk aplikohet. |
| Informimi në rast refuzimi të kredisë<br><br>*Banka duhet të informojë konsumatorin, menjëherë dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim. Kjo nuk aplikohet nëse dispozitat e këtij informacioni janë të ndaluara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.* | Banka informon klientin menjëherë dhe pa komisione nëse aplikimi i tij për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion dhe arsyet mbi te cilat është bazuar ky refuzim. |
| E drejta e pajisjes me kopjen e projektkontratës së kredisë<br><br>*Konsumatori ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin.* | Konsumatori ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin. |
| Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit, në rast ndryshimesh të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës | Konsumatori informohet rregullisht sipas mënyrës së rënë dakord në kontratë, por jo më pak se një herë në vit, për gjendjen/pasqyrën e llogarisë së tij rrjedhëse/të pagës.<br><br>Çdo kusht i ndryshuar në kontratë bëhet me amendim kontrate dhe me nënshkrimin e këtij dokumenti nga të dy palët si Banka dhe klienti. Asnjë ndryshim në kontratë nuk bëhet pa praninë e klientit. |
| Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt bankës | Një ankim mund të depozitohet përmes kanaleve të mëposhtëm:<br>- Duke plotësuar formën e dedikuar në faqen zyrtare të RBAL<br>- Në aplikacionin mobile Raiffeisen ON<br>- Pranë degëve të Bankës Raiffeisen<br>- Duke telefonuar Shërbimin e Klientit në +355 4 2381 381<br>- Duke shkruajtur në adresën e e-mail: ankesa.online@raiffeisen.al |
| Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor. | Ky informacion është i vlefshëm prej datës …/.../.... deri në datën …/.../…. |

Konsumatori
*(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)*

(emër mbiemër, nënshkrimi)

Date/Muaj/Vit: ____/____/_________

**ANEKS**

Njoftim mbi përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj Bankës.

- Duke pasur në konsideratë se hetimet e Autoritetit të Konkurrencës përgjithësisht nuk kanë në fokusin e tyre aksesimin dhe përpunimin e të dhënave personale të klientëve të subjekteve-objekt inspektimi për të kryer inspektime dhe për të konkluduar mbi funksionimin/zbatimin e drejtë të rregullave të konkurrencës nga aktorët e tregut.

- Duke pasur parasysh se Banka nga ana e saj si entitet kontrollues,vepron në përputhje me Ligjin nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe Udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, merr masa që infomacioni, i cili përfshin të dhëna personale dhe sensitive të klientëve, të vihet në dispozicion Autoritetit të Konkurrencës në mënyrë statistikore dhe të enkriptuar, për të ruajtur privatësinë e klientëve si subjekte të të dhënave personale.

- Në qoftë se, për përmbushjen e qëllimit të një inspektimi specifk, Autoriteti argumenton se e ka të pamundur realizimin e përmbushjes së qëllimit të inspektimit pa përpunuar të dhëna personale të klientëve apo/dhe të dhëna sensitive të klientëve, ky përpunim do të mundësohet vetëm bazuar në autorizimin paraprak të klientit, në përmbushje të nenit 7, pika 1 gërma a), nenit 8 pikat 1,2,3,4,5 dhe nenit 9 pika 2 germa a) e Ligjit nr 124/2024".